



Familja
Floortech

Tipologjia
Vonues ngurtësimi për shtresat mbështetëse çimentoze

Linjat e produkteve
• **Building**
• **Sanageb**
• **Floor**

Kategoritë e përdorimit
• **Trajtime sipërfaqësore dhe riparime të dyshemeve industriale në beton**
• **Realizimi i dyshemeve në "zhavorrit të larë"**

Përbërësit
Monokomponent

Paraqitja
I lëngshëm

FLR.0236

PRERIT SOLUTION

Vonues ngurtësimi sipërfaqësor
për dyshemetë në beton të lagur

Kodi doganor

3824 4000

Amballazhimi

- Bidon 10 kg
- Bidon 25 kg
- Bidon 5 kg

Aplikimi

- Spërkatje pa ajrim me presion të ulët.

Përshkrimi i produktit

Vonues ngurtësimi në tretësirë ujore që aplikohet, nëpërmjet pompës pa ajrim me presion të ulët, në sipërfaqe betoni të freskët, me qëllim që të mund të hiqet përmes hidrolavazhit, një shtresë koreje prej pak milimetrash, e të mund të hiqen inertet përbërëse të konglomeratit të çimentos. Veçanërisht për realizimin e dyshemeve me vlerë peizazhore/ambjentale me teknikën e "zhavorrit të lagur".

Të dhëna shtesë

Vonues ngurtësimi sipërfaqësor, në tretësirë ujore, gati për përdorim; me bazë polikaridesh, katalizues të veçantë dhe agjentë antishkumë, realizon pengimin e reaksionit të hidratimit të çimentos dhe ngadalëson shpejtësinë e ngurtësimit, vetëm për një shtresë sipërfaqësore prej pak milimetrash, duke mos ndryshuar në asnjë mënyrë vetitë e shtrimit të dyshemeve në beton. Agjenti aktiv i PRERIT SOLUTION përfaqësohet për më tepër prej kripës së natriumit të acidit glukonik, i njohur si "sodë glukozë" i cili, i përfutur nga fermentimi i glukozës, formon kelatë të qëndrueshëm me metale të ndryshme, veçanërisht në tretësirat alkaline të tipit ujë/çimento. Kripa e natriumit e acidit glukoni, që përfaqëson përbërësin kryesor aktiv të PRERIT SOLUTION, është një përbërës me origjinë natyrore, e biodegradueshme (deri në 98% pas 2 ditësh), që nuk shkakton kollë, rreziqe ndjeshmërie dhe efekte irrituese, të zakonshme për produktet në kontakt me lëkurën, si kremërat për fytyrën dhe trupin, shampot, balsamet, sapunet, produktet për make up. etj. që gjenden, në shumë versione, si shtesë ushqimore për rregullimin e aciditetit.

PRERIT SOLUTION nuk është një produkt stazhionues i veçantë. Veprimi i tij ka për qëllim zgjatjen e fazës së parë të hidratimit të çimentos, të karakterizuar nga formimi i një "xheli" të çimentos përkohësisht të papërshkueshëm. Prandaj mund të thuhet se prania në sipërfaqen e konglomeratit, të një xheli që pengon avullimin e shpejtë, të ujit përzierës, kryen një veprim efektiv përmirësues.

Fakti që PRERIT SOLUTION hiqet më pas, për të nxjerrë në pah agregatët sipërfaqësorë të konglomeratit, nuk e ndryshon vlerësimin pozitiv të ndërhyrjes përmirësuese pasi, siç dihet, momenti më kritik për betonin, në kuptim të efekteve të dëmshme të një avullimi të shpejtë të ujit, është saktësisht në orët e para pas hedhjes.

Konsumi


Nga 0,10 deri në 0,15 kg të PRERIT SOLUTION për çdo metër katror të sipërfaqes për t'u çaktivizuar.

Fushat e përdorimit


Realizimi i dyshemeve në beton me vlerë të lartë estetike me teknikën e "zhavorrit të larë" (me agregate "të ekspozuara").


Vetitë kryesore


 I pandezshëm


 Jetëgjatësia:
6 muaj

 Pa tretës

 Pesha specifike:
1.03 kg/dm³

 Rezistent ndaj rrezeve UV

 Temperatura e aplikimit:
+5 / +35 °C

 Ngjyrat në dispozicion
E kaltër

IF YOU WANT TO SOLVE IT


www.azichem.com

Përditësimi më: **30/03/2021**
Kushtet e shitjes dhe parashikimet
ligjore mund të lexohen në
www.azichem.it/disclaimer

Mjetet e pastrimit

- Ujë

Shtresat e lejuara

- Beton
- Nënshtrësa çimentoje

Mënyra e përdorimit

Vini në veprim dhe lagji, me metodat e zakonshme një shtresë betoni në bazë të kërkesave të projektit dhe të parashikimeve të rregullooes.

PRERIT SOLUTION duhet të përdoret i pastër (pa u holluar). Në një shtresë betoni ende "të freskët", aplikoni nëpërmjet spërkatjes vonuesin e ngurtësimit, në sasinë e përcaktuar në provat paraprake, në funksion të thellësisë së "larjes" së dëshiruar. Zakonisht, për një thellësi spërkatjeje deri në 2-3 mm, doza e produktit është e barabartë me 100-150 g/m².

Në mënyrë indikative, pas një kohe që ndryshon midis 2 dhe 24 orësh, hiqeni pastën e çimentuar sipërfaqësore të vonuar, me larje presioni që mund të shkojë nga 120 deri në 200 bar, duke shfaqur zhavorrin sipërfaqësor. Koha e larjes dhe presionet varen nga kushtet klimatike në të cilat po kryhet puna, modeli i përzierjes së betonit dhe ndryshoreve të tjera. Bëni teste paraprake për të kalibruar më mirë këto parametra të rëndësishëm.

Magazinimi e Ruajtja

Ruhet nga ngrica. Ruajeni produktin në ambalazhimin origjinal, në një mjedis të freskët dhe të thatë, duke shmangur acarën dhe rrezet e drejtpërdrejta të diellit. Ruajtja e papërshtatshme e produktit mund të shkaktojë humbje të vetive reologjike.



Mendime për dyshemenë me "zhavorr të larë"

Me dysheme me "zhavorr të larë" nënkuptohen ato dysheme në të cilat shtresa sipërfaqësore apo e kores hiqet, në një trashësi prej disa milimetrash, me një hidrolavazh me presion, me qëllim që të nxirren në pah ("në dukje") gurishtet që përbëjnë vetë konglomeratin. Inertet që përbëjnë betonin do të dalin në pah dhe do të duken; kështu këto sigurojnë një pjesë shumë të rëndësishme të efektit estetik përfundimtar të veprës. Kështu përdorimi i inerteve të rrumbullakta dhe me ngjyrë, të mbështjella me çimento të bardhë, për shembull, kur trajtohen me metodën e "zhavorrit të larë", i japin shumë vlerë estetike veprës së përfunduar (në krahasim me betonin me inerte të copëtuara, zakonisht me ngjyrë gri, të lidhur me çimento gri). Do të mbesin të pandryshuara vetitë teknike/strukurore të dyshemesë origjinale (cilësia dhe dozimi i çimentos, tipi dhe natyra e konglomeratit, rezistenca me ngjeshje, trashësia, armaturat e mundshme, etj.)

Për realizimin e shtrimit të dyshemeve të shkëlqyera me teknikën e "zhavorrit të larë", me vlerë të jashtëzakonshme estetike dhe funksionale, ne rekomandojmë që të ndiqni kërkesat dhe këshillat e mëposhtme:

1. Përgatisni betonin me çimento të bardhë 42.5 R, të dozuar në jo më pak se 350 kg / m³.
2. Përdorni agregatët e rrumbullakët (jo të grimtuar) me të paktën 4 ngjyra të ndryshme, të zgjedhura nga klienti sipas shijet estetike dhe me një madhësi copash nga 1 mm deri në 12 mm.
3. Shtoni në beton, me një normë prej 1 kg / m³, fibra polypropylene të READYMESH PM-180.
4. Bëni një shtresë me trashësi prej të paktën 10 cm.
5. Trajtoni pjesën e kores së dyshemeve, pas trajtimit hidropulitik, me tretësirën e silikatit të litium QL NANO LITHIUM.



www.azichem.com

Përditësimi më: **30/03/2021**
Kushtet e shitjes dhe parashikimet
ligjore mund të lexohen në
www.azichem.it/disclaimer

Paralajmërimi, Masa paraprake, Ekologji

Të dhënat e përgjithshme, ashtu si dhe indikacionet dhe sugjerimet për përdorimin e këtij produkti, të paraqitura në këtë fletë teknike të të dhënave dhe mundësisht të shpjeguara dhe me gojë ose me shkrim, përputhen me gjendjen aktuale të njohurive tona shkencore dhe praktike.

Të dhënat teknike dhe të performancës të paraqitura janë rezultat i provave laboratorike të kryera në një mjedis të kontrolluar dhe si të tilla mund të ndryshojnë në lidhje me kushtet e vënies në funksionim.

Azichem Srl nuk merr asnjë përgjegjësi që rrjedhin nga performanca jo e duhur që ka lidhje me përdorimin jashtë rregullave të produktit, ose që ka lidhje me defektet që rrjedhin nga faktorë ose elementë që nuk kanë lidhje me cilësinë e produktit, duke përfshirë këtu dhe konservimin e pasaktë.

Kushdo që synon të përdorë produktin duhet të vendosë, para përdorimit, nëse është i përshtatshëm për përdorimin e synuar, duke marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë e tij.

Karakteristikat teknike dhe të performancës të përfshira në këtë fletë të dhënash teknike përditësohen në mënyrë periodike. Për një konsultë në kohë reale lidhuni me sitin: www.azichem.com. Data e rishikimit paraqitet në cep të produktit. Ky njoftim anulon dhe zëvendëson çdo njoftim tjetër të mëparshëm.

Mos harroni se përdoruesi është i detyruar të lexojë Fletën më të fundit të të Dhënave të Sigurisë së këtij produkti, që përmban të dhëna kimike-fizike dhe toksikologjike, parashikimet e rrezikut dhe informacione të tjera me qëllim që të transportojë, përdorë dhe asgjësojë produktin dhe paketimin e tij me siguri të plotë. Për konsultim lidhuni me sitin: www.azichem.com.

Ndalohet hedhja e produktit dhe / ose amballazhit të tij në mjedis.

Efekti estetik ndikohet ndjeshëm nga thellësia e heqjes së shtresës së kores së betonit. Për të arritur rezultatet më të mira, këshillohet që të kryhen provat paraprake me materialet dhe në kushtet e punës që do të karakterizojnë përpunimin. Kohët e vonës dhe trashësia e larjes varet në fakt nga disa faktorë të tillë si lloji i çimentos, sasia e çimentos, largësia nga qendra e përpunimit të betonit dhe vendit të shkarkimit, raporti ujë / çimento, temperatura e betonit të freskët, temperatura e ambientit, ventilimi etj.

Kryerjen e fazës së hidrolavazhit brenda 24 orëve nga dita e realizimit të dyshemesë; një pritje e tepruar mund të kompromentojë efektivitetin e spërkatjes e të mos e arrijë rezultatin e dëshiruar të "zhavorrit të larë".

SHËNIM: kushtet termike të verës mund të ndikojnë në kohëzgjatjen e periudhës së pritjes së lejuar para heqjes së sipërfaqes së dyshemeve të përfunduara.

Për të zvogëluar efektet e përmendura, duhet të përdoren doza të moderuara të produktit të aplikuar (pas provave përkatëse paraprake).

PRERIT SOLUTION prodhohet/shpërndahet nga



Via Giovanni Gentile, 16/A - 46044 Goito (MN), Itali
info@azichem.com Tel. +39 0376.604185 /604365 Fax +39 0376 604398



www.azichem.com

Përditësimi më: **30/03/2021**
Kushtet e shitjes dhe parashikimet
ligjore mund të lexohen në
www.azichem.it/disclaimer